

VENDIM
Nr. 302, datë 17.5.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT MUJOR TË PËRHERSHËM
PËR TITULL TË ANËTARËVE TË ASAMBLESE SË AKADEMISË SË SHKENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e Asamblesë së Akademisë së Shkencave përfitojnë një shpërblim mujor të përherëshëm, për titullin “Akademik”, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, dhe për titullin “Akademik i asociuar”, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë), edhe nëse marrin statusin e anëtarit “*Emeritus*”.

2. Dhënia e shpërblimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi kryhet nga Akademia e Shkencave dhe përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për këtë institucion.

3. Akademisë së Shkencave, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 15 900 000 (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekësh, i cili përballohet nga fondi i kontingjencës, i buxhetit të vitit 2023.

4. Vendimi nr. 399, datë 27.3.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt, të anëtarëve të përherëshëm dhe të anëtarëve të asociuar të Akademisë së Shkencave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 qershor 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku